



## **Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, seancat u mbajtën të hënën dhe të martën e kësaj jave. Dy ekspertë mjekoligjorë dhanë dëshmi pa masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë publike. Ata ishin dëshmitari i nëntë dhe i dhjetë të thirrur nga Prokuroria për këtë çështje gjyqësore. Dëshmitarëve u drejtoi pyetje Prokuroria, Mbrojtja, Mbrojtësi i Viktimave dhe Gjykatësit.

Sipas urdhrorit me gojë të 16 qershorit, me të cilin Trupi Gjykes caktoi disa data të synuara, Prokuroria, pas dëshmisë së dëshmitarit të fundit, pritet të përfundojë paraqitjen e provave të veta sot, më 6 korrik. Më pas, në varësi të rezultatit të ndonjë mocioni prej Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave, 21 gushti është data në të cilën synohet fillimi i paraqitjes së provave nga Mbrojtësi i Viktimave, nëse dëshiron. Së fundi, Trupi Gjykes caktoi 18 shtatorin si datën në të cilën synohet të fillojë paraqitja e provave nga Mbrojtja.

Seancat në çështjen gjyqësore *Shala* përfunduan për këtë javë dhe do të rifillojnë më 21 gusht 2023 në orën 9:30.

Më 28 qershor, Prokuroria dorëzoi listën e 12 dëshmitarëve të tjerë që do të thirren në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*. Lista përmban edhe dëshmitarë rezervë dhe Prokuroria theksoi se ka zvogëluar kohën e parashikuar që duhet për të marrë në pyetje tetë prej këtyre dëshmitarëve. Emrat e dëshmitarëve janë dorëzuar si pjesë e një shtojcë konfidenciale.

Seancat në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë* rinisin javën e ardhshme, duke filluar nga 10 korriku në orën 9:00.

## **Pyetje nga gazetarët**

